



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 13.05.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **07.05.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **ALFA.I SH.P.K**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Ndërtimi i QKMF ne Istog**" me Nr. të Prok: **206-23-6380-5-1-2** nxjerr:

**V E N D I M**

1. **REFUZOHET**, si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **ALFA.I SH.P.K** e dt. 07.05.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Ndërtimi i QKMF ne Istog**" me Nr. të Prok: **206-23-6380-5-1-2** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të datës 30.04.2024.
2. **Mbetet ne fuqi**, Njoftimi mbi Vendimin e AK i datës 30.04.2024.
3. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik **ALFA.I SH.P.K** me dt. 07.05.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "**Ndërtimi i QKMF ne Istog**" me Nr. të Prok: **206-23-6380-5-1-2**. AK-MSh me datë 13.05.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

**Neni 1 i LPP-së**  
**Neni 7 i LPP-së**  
**Neni 56 i LPP-së**  
**Neni 59 i LPP-së**  
**Neni 60 i LPP-së**  
**Neni 69 i LPP-së.**

## Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Njoftimi për kontratë është publikuar me dt. 26.06.2023, kurse hapja e ofertave është bërë me dt.15.04.2024, ku kanë ofertuar gjithsejtë katër operatorë ekonomik.

Autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë Grupin e OE AAG PROJEKT & Shkëmbi Shpk & Enggroup SH.P.K., & ALPING SH.P.K., ndërsa neve na ka shpallur si tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Oferta juaj ka tejkalim substancial te buxhetin te parashikuar ne dosje te tenderit për 261,164.32 €.

Buxheti i Planifikuar ne Dosje te tenderit	Oferta e OE: ALFA.I	Vlera e tejkalimit te buxhetit
2,431,353.85 €	2,692,518.17 €	261,164.32 €

Oferta juaj është e pa përgjegjshme edhe sa i përket afatit të kryerjes së punëve, ku ka mospërputhje në mes FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT të plotësuar në system - Afati me i shkurtet i realizimit të punëve 180 dite. Ndërsa Planin Dinamik e ka plotësuar për afatin e kryerjes së punëve 150 ditë.

Duke marrë parasysh se procedura ka qenë TEMF, afati për kryerjen e punëve ka qenë si nënkriter për dhënie të kontratës dhe ky afat konvertohet në pikë dhe vlerë në konkurrencë në mes OE.

Fillimisht ju sqarojmë se arsyet e autoritetit kontraktues për eliminimin tonë janë të paqëndrueshme për arsyet si në vijim:

Sa i përket tejkalimit të vlerës së parashikuar, sqarojmë se kriter kryesor për dhënie të kontratës është tenderi ekonomikisht më i favorshëm, e ku janë të përcaktuara edhe nën kriteret e poentimit, e ku rezulton se nuk është kriter i vetëm çmimi më i ulët, por në këtë rast bëhet poentimi i nën kriterëve, prandaj vlerësimi i nën kriterëve është dashur të bëhet për të gjithë ofertuesit e përgjegjshëm, pavarësisht çmimit të ofruar.

Po ashtu në dosje të tenderit askund nuk ka qenë e përcaktuar që nëse tejkalohet vlera e parashikuar duhet të eliminohen operatorët ekonomik apo se nuk do të vlerësohen ofertat e tyre. Përderisa nuk ka qenë një kërkesë e tillë në dosje të tenderit atëherë rezulton se ne jemi eliminuar për një kërkesë që nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit dhe është vepruar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Arsyeja tjetër në lidhje me eliminimin tonë, ku autoriteti kontraktues e ka cekur se ka mospërputhje në mes të formularit për dorëzimin e tenderit të plotësuar në sistem, sa i përket afatit të planit dinamik ku tek formulari është shënuar 180 ditë, ndërsa tek plani dinamik është 150 ditë, kjo arsye e AK-së është e paqëndrueshme.

Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë një arsyetim konkret, mirëpo e ka cekur se procedura ka qenë TEMF dhe ky afat konvertohet në pikë dhe në vlerë, mirëpo një arsyetim i tillë është i paqëndrueshëm.

Tek plani dinamik është detajuar koha e kryerjes së punimeve, prandaj është dashur të merret parasysh ky plan dinamik, ndërsa sa i përket afatit të shënuar tek aneksi 4 ku është shënuar 180 ditë, sqarojmë se në këtë rast ka ndodh një lëshim teknik gjatë shënimit të tij, mirëpo në këtë rast është dashur të kërkohen sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së

Pavarësisht këtij fakti, cilido afat që do të merrej parasysh për vlerësimin e ofertave, ne si kompani përsëri kemi ofruar afatin më të shkurtër për kryerjen e punëve.

Autoriteti kontraktues nuk ka bërë vlerësim të nënkriterëve fare dhe nuk është dëshmu fare një gjë e tillë, prandaj vlerësimi i ofertave nuk është bërë në harmoni me kriterin kryesor për dhënie të kontratës dhe me nënkriteret e poentimit.

Kjo dëshmohet edhe me raportin e vlerësimit që e kemi pranuar gjatë qasjes, ku shihet që nuk ka asnjë poentim në lidhje me nënkriteret e poentimit.

Ne si kompani kemi pasur qasje në dokumentet e të gjithë OE ofertues, ku pas analizës që i kemi bërë ofertave të tyre e kemi vërejtur që OE kanë dhënë afatin e përfundimit të punëve si në vijim:

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë OE AAG PROJEKT & Shkëmbi Shpk & Enggroup SH.P.K., & ALPING SH.P.K., e ka prezantuar planin dinamik 580 dite kalendarike.

Grupi i OE Construmax SH.P.K.; TOP PROJEKT SH.P.K.; HARST Group SH.P.K., e ka prezantuar planin dinamik 225 dite kalendarike.

Grupi i OE Valmir Loshi B.I. & Benita Company, e ka prezantuar planin dinamik për 256 dite kalendarike.

Pra nga sqarimet e lartcekura kuptohet qartë se edhe nëse do të merrej parasysh deklarata për plan dinamik prej 180 ditë, në të dyja rastet ne duhet të vlerësohemi me 20% e pikëve siç është përcaktuar në dosje të tenderit, andaj arsyeja e autoritetit kontraktues është e pa qëndrueshme dhe e pa bazuar.

Nga përlllogaritjet tona sipas nënkritereve të poentimit rezulton se ne kemi ofruar tenderin ekonomikisht më të favorshëm dhe renditemi me pikë totale, më shumë se sa OE i rekomanduar për kontratë dhe më shumë se ofertuesit tjerë.

Edhe nëse llogaritet plani dinamik për 180 ditë, ne jemi tenderi ekonomikisht më i favorshëm dhe me pikë totale prej 91 pikë gjithsejtë, kurse OE i rekomanduar për kontratë renditet i treti me 80.06 pikë totale. I dyti renditet OE Construmax SHPK&Top projekt SHPK&Harst me 84 pikë totale, prandaj vlerësimi nuk është bërë në harmoni me kriterin kryesor për dhënie të kontratës dhe me nën kriteret e poentimit.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse oferta jonë është e përgjegjshme dhe i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi ekonomikisht më i favorshëm, konform nenit 60 paragrafi 1.2 i LPP-së.

Mbi bazën e këtyre sqarimeve dhe dëshmimeve të cekura më lartë rezulton se në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Në këtë rast ne nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë por jemi diskriminuar"*.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *"Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo AK-së nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të marr:

#### Dëmet materiale

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 15,000.00 euro.

#### Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

Pretendimet e juaja ankimore i konsiderojmë te pa bazuara dhe njekohesisht i konfirmojmë arsyet e eliminimit te ofertës tuaj, te dërguar me datën 30.04.2024, se oferta juaj ka tejkallim substancial te buxhetin te parashikuar ne dosje te tenderit për 261,164.32 €.

Ne këtë aktivitet ne e kemi një oferte nen buxhetin e parashikuar dhe e kemi shpërblyer me kontrate, ne te kundërtën aktiviteti do te anulohet, referuar paragrafit 2.1 te nenit 62 te LPP-se, te Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit, ku ceket se: të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;

Sa i përket pretendimit të kriterit të tenderit ka qene TEMF - Tenderi ekonomikisht me i favorshëm dhe se është dashtë të poentohen nën kriteret për të gjithë OE e përgjegjshëm, në poentim nuk mund të përfshihen ofertat mbi buxhetin e parashikuar.

Në Dosjen e tenderit të fazës së dytë të tenderimit, t5e FTD ka qene e specifikuar vlera e parashikuar:

Vlera e parashikuar	2.4	2,431,353.85 €
---------------------	-----	----------------

Gjithashtu ka qene e parapare edhe afati për sqarime në DT:

Sqarimi i Dosjes së Tenderit	9.1	04.04.2024
------------------------------	-----	------------


Ju është dashtë që në këtë fazë të kërkontë nga AK-MSh të rishikohet vlera e parashikuar nëse nuk ka qene e mjaftueshme, por nuk keni reaguar dhe keni ofertuar mbi buxhetin të parashikuar për 261,164.32 €.

Sa i përket afatit të kryerjes së punëve, ku edhe me ankesën tuaj e keni konfirmuar se ka mospërputhje në mes FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT të plotësuar në sistem me afatin e realizimit të punëve 180 dite, ndërsa në Planin Dinamik e ka plotësuar për afatin e kryerjes së punëve 150 ditë, kjo përben variant në ofertën tuaj dhe nuk kemi mundur të kërkojmë sqarime shtesë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit